



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI
ADRESA NR.3, HOXHA TASIM,
NR.292
TEL: 695761243

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4847

Nr. koleksioni: 1840

Tirane më 02/08/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023052730193287049

SH
SINOIP
KIA





A2023052730193287049

MARRËVESHJE PËR BLERJEN E KUOTAVE

(“Marreveshja”)

Sot, me 2.08.2023, para meje noteres Valbona Selimi, notere ne Tirane, me seli ne Rrugen Hoxha Tahsim, nr. 292, u paraqiten personalisht ne zyren time palet e meposhtme:

- **Shoqeria "Albanica" shpk, me NIPT M11909017M, perfaqesuar nga administratori Z. Nelson Cela**, atësia Servet, amësia Mbarime, shtetas Shqiptar, lindur në Tërrovë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Shefqet Musaraj; Nd. 54; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 28/09/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036014214 dhe nr. personal I40928094V, dhe Z. Valon Lluka, atësia Masar, amësia Miljane, shtetas Shqiptar, lindur në Gjakovë, Kosova (XKS) dhe banues në Tiranë, me adresë Donika Kastrioti; Nd. Nd.1; H. 4; Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 10/05/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034486492 dhe nr. personal H50510285B, më tej referuar si **"Shitesi"**,

dhe

- **A&A Investment Sh.P.K.**, shoqeri e regjistruar ne Kosove me nr. unik identifikues 811573569, me seli ne Prishtine, Rruga UCK, Kompleksi Qafa nr. 1, **me drejtor menaxhues Anduen Cana**, i biri i Shefqet, shtetas kosovar, lindur me 15.08.1984 ne Prishtine, banues ne: Rr. Robert Doll 25/37, 10000 Prishtine, Kosove, i identifikuar me pasaporten kosovare me nr. P01509512 e me nr. personal 1500996010, me tej referuar si **"Bleresi"**.

HYRJE

- A. Shitesi eshte ortak i vetem i shoqërisë "GREEN COAST HILLS" shpk, e organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik me NUIS M11908032E, me adresë Rruga Donika Kastrioti, Godina Koton Center Nr.3, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane, me kapital te regjistruar 1.000 leke (më tej referuar si **"Shoqëria"**), ku Shitesi zoteron 100%.
- B. Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi dhe Shitësi dëshiron t'i shesi Blerësit 32,5% te kapitalit themeltar te Shoqerise (ne vijim referuar **"Kuota"**);
- C. Per sa me siper, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të angazhimit të tyre respektiv për shitjen dhe blerjen e kuotave.

PALET BIET DAKORD SA VIJON:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Termat me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

"Barrë" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individ (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi per te blere ne te ardhmen apo te drejte parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigurues (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajte te drejte ose cdo marrveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër



A2023052730193287049

barresues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjeter per pagim me rezerve;

"Qendra Kombëtare e Biznesit" nënkupton organin publik Shqiptar që ka kompetencën e regjistrimit në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

2.1 Shitja e Kuotave

Ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete Marrëveshje Shitësi shet duke kaluar në pronësi të plotë të Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi Kuoten qe perben 32,5% të kapitalit të Shoqërisë. Si rrjedhoje e kesaj shitje Bleresi behet zoterues i 32,5% te kapitalit te Shoqerise, me vlere 325 leke.

2.1.1 Transferimi i Kuotes bëhet në përputhje me kete Marreveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

2.1.2 **Titulli i pronesise mbi Kuoten transferohet tek Blerësi ne momentin e lidhjes se kesaj marreveshje.** Kuota shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe perfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri ne daten e kalimit te ponesise mbi Kuoten (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin, shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri me sot), të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre

2.2 Cmimi i Blerjes

Blerësi i paguan Shitësit per blerjen e Kuotes shumen totale prej 325 leke.

2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

Palet deklarojne se pagesa e cmimit te blerjes eshte shlyer rregullisht mes paleve.

2.4 Vendimi i Ortakut

Shitesi deklaron se e miraton kete shitje kuotash dhe se kete miratim e reflektojne ne vendimin e ortakut te Shoqerise qe vendos mbi miratimin e transferimit të Kuotes nga Shitësit tek Blerësi.

3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet

3.1.1 Kjo Marrëveshje zhvleftëson cdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.

3.1.2 Cdo ndryshim i kësaj Marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshje.

3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.



A2023052730193287049

3.3

Regjistrimi i Marreveshjes

Palet bien dakort se regjistrimi i Marreveshjes ne Qendren Kombëtare te Biznesit do te behet nga Bleresi ose vete Shoqeria brenda nje afati 15 ditor.

4.

LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

* * *

Akti u redaktua konform vullnetit te plote te paleve te cileve pasi ua lexova marreveshjen dhe pasi deklaruan se u kuptua prej tyre, dhe e miratojnë ate, e nenshkruan rregullisht para meje noteres dhe une noterja vertetoj nenskrimin e tyre konform Ligjit. Kjo kontrate u nënshkrua ne adresën: Rruga Donika Kastrioti, Godina Koton Center Nr.3, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane. Pulla e taksës ne vlerën 700 leke u aplikua ne kopjen e aktit te ruajtur ne arkiven time noteriale.

Palet**Shoqeria "Albanica" shpk****Administratori Z. Nelson Cela***Nelson***Z. Valon Lluka, përfaqësues i autorizuar***Valon Lluka***A&A Investment Sh.P.K.****drejtor menaxhues Anduen Cana***ANDUEN CANA**Anduen Cana***Noter****Valbona Selimi***Valbona Selimi*

